



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR INFORMACION NË FUSHËN E MJEDIST DHE TURIZMIT

JANAR- PRILL 2023

Nr . (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja(5)	Statusi i kërkesës (6)	Tarifa (7)
1.	17.01.2023	Kërkesë për informacion: Në datën <b>1 Shtator 2021</b> , Kryeministri Edi Rama në një njoftim publik në mediat sociale (gjendet në këtë link	30.01.2023	1. Është hartuar projektligji "Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare". Me datë 17.06.2020 është publikuar për konsultim me publikun. Është konsultuar drafti me institucionet e tjera të përfshira në proces. Me datë 15.04.2021, nëpërmjet sistemit e-aktet, projektligji "Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare" së bashku me relacionin shoqërues është kthyer nga Kryeministria për "rivlerësim të nismës" në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.	Përfunduar	0

		<p><a href="https://www.facebook.com/ediramaal/video/s/548260516447779">https://www.facebook.com/ediramaal/video/s/548260516447779</a> ) ka njoftuar se shumë shpejt do të propozohet një ligj i ri për menaxhimin e vijës bregdetare, në vijim të operacionit “Bregdeti Ynë”.</p> <p>Lidhur me këtë çështje kërkohet informacion se në çfarë faze është ky projektligj (Në fazën e hartimit, konsultimit publik, në Kuvend dhe pret miratimin apo është miratuar)? Çfarë parashikohet në këtë ligj për ndërtimet pa leje që kanë zaptuar hapësira publike në vijën bregdetare?</p>		<p>Aktualisht është stopuar nisma për shkak të vlerësimit të kompetencave të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit në lidhje me menaxhimin e gjithë zonës bregdetare.</p> <p>2. Projektligji ka për qëllim menaxhimin e integruar të zonës bregdetare, garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm të saj, në harmoni me planin e përgjithshëm kombëtar si dhe me planin sektorial kombëtar të turizmit, nxitjen e aktiviteteve dhe veprimtarive për mbrojtjen, administrimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimit në zonën bregdetare si dhe përcaktimin e institucioneve përgjegjëse, për administrimin e kësaj zone.</p> <p>Objektivat që synohen të arrihen përmes miratimit të këtij projektligji dhe zbatimit të tij janë: (i) garantimi i zhvillimit të qëndrueshëm të zonës bregdetare si dhe sigurimi i mbrojtjes dhe zhvillimit racional; (ii) përcaktimi për herë të parë i kufijve të bregut të detit dhe brezit të zhvillimeve të qëndrueshme; (iii) dhënia e një statusi të veçantë juridik zonës bregdetare; (iv) përcaktimi i bregut të detit si pronë e patjetërsueshme; (v) ndalimi i ndërtimeve në bregun e detit si dhe disiplinimi i ndërtimeve në brezin e zhvillimeve të kontrolluara në harmoni me bregun e detit.</p>		
3.	18.01.2023	Kërkesë për informacion për relacionet e projekt vendimeve: 59	30.01.2023	Kthyer përgjigje bashkëlidhur informacionin e kërkuar.	Përfunduar	0

		<p>10.10.22 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", të ndryshuar” 691</p> <p>26.10.22 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 360, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre”” 694</p> <p>26.10.22 “Për ndryshimin e statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemit natyror/ligatinor "Pishë Poro-Nartë" nga "Rezervat Natyror</p>				
--	--	---	--	--	--	--

		<p>i Menaxhuar " në "Peizazh i Mbrojtur" dhe heqjen e statusit "Zonë e Mbrojtur" të sipërfaqes së pakësuar” 888</p> <p>27.12.22 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre” 889</p> <p>27.12.22 “Për miratimin e rregullores për monitorimin, raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe të informacioneve të tjera, që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar”</p>				
3.	18.01.2023	Kërkesë për informacion: 1. A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat	30.01.2023	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ka ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse gjatë vitit 2022, në mbështetje të pikës 8, të nenit 31, të Ligjit nr.93/2015, “Për turizmin” dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të	Përfunduar	0

	<p>jofitimprurëse (OJF) gjate vitit 2022? 2. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, cila ka qene forma e mbështetjes (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.) 3. Sa OJF kane aplikuar për mbështetje financiare gjate vitit 2022? Ju lutem, specifikoni sipas formës se mbështetjes, nëse ka patur me shume se një forme. 4. Sa OIF kane përfituar nga kjo mbështetje? Ju lutem, specifikoni sipas formës se mbështetjes nëse ka patur me shume se një forme 5. Cila ka qene buxheti i disbursuar për organizate dhe ne total? Ju lutem, specifikoni sipas formës nëse ka patur me shume se një tone 6. Keni ofruar mbështetje jo financiare gjate vitit 2022? Cila është baza ligjore rregullatorë qe rregullon këtë forme mbështetjeje? 7. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, sa OIF kane përfituar nga</p>		<p>Ministrave nr. 281, datë 13.04.2016 “Për caktimin e kriterëve dhe afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetje financiare në fushën e turizmit”.</p> <p>Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.04.2016 dhe nëpërmjet Thirrjes për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit, për vitin 2022, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet fondeve të parashikuara në buxhetin e shtetit, financon projekte studimi, promovimi dhe edukimi apo modele inovative të produkteve turistike, në funksion të turizmit. Përsa i përket thirrjes se projektpropozime për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit, kanë aplikuar në total 90(nëntdhjetë) OJF. Përsa i përket thirrjes së projektpropozime për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit, kanë përfituar 23 (njëzetë e tre) OJF.</p> <p>Në zbatim të pikës 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.04.2016 “Për caktimin e kriterëve dhe afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetje financiare në fushën e turizmit”, për realizimin e projekteve konkurruese turistike, skema e financimit, për secilin nga subjektet e shpallura fituese, mbulon deri në 50% të kostove të pranuar e të miratuara nga MTM. 23 (njëzetë e tre) OJF përfituese nga thirrjet e projektpropozimeve në fushën e turizmit kanë përfituar në total 45,399,450 Lekë.</p> <p>Gjatë vitit 2022 janë realizuar 6 proceduara te konsultimit me publikun bazuar në zbatimin e përcaktimeve të ligjit nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)” për shprehjen e qëndrimit mbi nevojën ose jo te realizimit të procesit të VSM-së për bashkitë Kukës, Dibër, Dimal, Vau i Dejës, Malësi e Madhe dhe Mirditë. Për pjesëmarrje në konsultim përveç ministrive te linjës janë njoftuar</p>		
--	---	--	---	--	--

		<p>kjo mbështetje? Cili ka qene lloji i mbështetjes jo financiare te ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj)? 8. Sa është numri i konsultimeve publike te realizuara nga institucioni juaj gjate vitit 2022? 9. A ka institucioni juaj koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin. 10. A ka institucioni juaj koordinator për shoqërinë civile? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin. 11. Sa OJF kane marre pjese ne konsultime publike te organizuara nga Institucioni juaj? 12. Sa përqind (%) e projektligjeve I akteve nënligjore te hartuara nga institucioni juaj janë si rezultat i konsultimeve me OJF-te? 13. Ajane te përfshire përfaqësues te OJF-ve ne organe këshillimore te institucionit tuaj? Nëse</p>		<p>nëpërmjet shkresave zyrtare dhe e-mail-it, Kryetarët e Bashkive kufitare te bashkisë qe ka propozuar ndryshim te PPV, Këshillit e Qarkut, Prefektura, dhe grupe te interesit si organizata mjedisore te ndryshme.</p> <p>gjithashtu janë zhvilluar konsultime me publikun edhe për projektligjet dhe projekt vendimet e mëposhtëm, te cilat kane qene te publikuara dhe në faqen e konsultimeve me publikun, ti cilat janë si më poshtë vijon:</p> <p>Vendimin " për ndryshimin e statusit dhe sipërfaqes të ekosistemit natyror ligatinor “Nartë – Pishë Poro” nga rezervat natyror i menaxhuar në “peizazh i mbrojtur” dhe heqjen e statusit zonë e mbrojtur të sipërfaqes së pakësuar. Vendimin “për shpalljen e ekosistemit natyror detar-bregdetar të gjirit Porto Palermos “park natyror”, kategoria iv.</p> <p>Për amendimin e ligjit “Për menaxhimin e integruar te mbetjeve”,  “Për ndalimin e qeseve plastike”.</p> <p>Gjithashtu është zhvilluar konsultim me Bashkitë për projektvendimin për amendimin "Për mbetjet spitalore". Projektligj për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162, datë 4.12.2014 “për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar.</p> <p>Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 27, datë 17.3.2016 “Për menaxhimin e kimikateve”.</p> <p>Projektligj për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 155/2020 “për ndryshimet klimatike” të ndryshuar.</p> <p>Projektvendimi “”Për miratimin e rregullores për monitorimin, raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe të informacioneve të tjera, që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar”,</p> <p>Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vkm nr. 360, datë 29.4.2015 “për miratimin e listës së</p>		
--	--	--	--	---	--	--

		<p>PO, cilat janë këto organe këshillimore dhe sa OJF janë te përfshire ne to? 14. A janë përfshirë OJF ne grupet e punës se ngritura te institucionit tuaj? Nëse PO, cilat janë këto grupe pune dhe sa OJF janë te përfshire ne to? 15. A është trajnuar stafi juaj mbi veprimtarinë dhe funksionimin e OJF-ve? Nëse po, sa punonjës janë trajnuar? 16. A ka licencuar institucioni Juaj OJF qe ofrojnë shërbime te caktuara? Nëse po, sa OJF janë licencuar? Për çfarë shërbimesh janë licencuar?</p>		<p>ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre””.</p> <p>Vendimin " për ndryshimin e statusit dhe sipërfaqes të ekosistemit natyror ligatinor “Nartë – Pishë Poro” nga rezervat natyror i menaxhuar në “peizazh i mbrojtur” dhe heqjen e statusit zonë e mbrojtur të sipërfaqes së pakësuar. Sa i përket procesit të konsultimit publik të këtij projektvendimi, pjese e konsultimeve publike për rishikimin e kufijve te zonave te mbrojtura, sqarojmë se, gjatë këtij procesi janë zhvilluar 44 takime e konsulta, në të 12 qarqet e vendit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar konsultimit me grupet e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e botës akademike. Gjatë gjithë këtyre takimeve janë mbledhur një numër i madh propozimesh të rëndësishme për rishikimin, ndryshimin apo zgjerimin e kufijve të zonave të mbrojtura si dhe shpalljen e zonave të reja të mbrojtura. Këto mendime e sugjerime të ardhura, janë reflektuar në mënyrën më të mirë të mundshme në këtë vendim.</p> <p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka patur Koordinator për Informimin Publik, znj. Gerzheta Akshia, informacioni në linkun bashkëlidhur. <a href="https://turizmi.gov.al/programi-i-transparences-2-2/">https://turizmi.gov.al/programi-i-transparences-2-2/</a></p> <p>Bëjmë me dije se, znj. Akshia është larguar nga detyra në datën 17.01.2023 dhe MTM është në fazën e miratimit të Koordinatorit të ri për Informimin Publik, informacioni i të cilit do të publikohet në faqen zyrtare të MTM-së.</p>		
4.	19.01.2023	Kërkesë për informacion: A ka Ministria e Mjedisit	31.01.2023	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka një plan investimi për sipërfaqet e gjelbra, ku nëpërmjet punimeve (mbjellje fidanë pyjore) edhe për vitin 2023 do	Përfunduar	0

		një plan veprimi për investimet e gjelbra ne Shqipëri? Nëse po, ju lutem me dërgoni një kopje.		te vazhdoje procesin e mbjelljes se fidanëve pyjor në zonat e mbrojtura me rreth 2000 fidanë.		
5.	19.01.203	<p>Kërkesë për informacion: A ka Ministria e mjedisit një plan veprimi mjedisore kombëtar për zonat urbane?</p> <p>A ka Ministria një plan ne zbatim te aplikuar për qytetin e Shkodrës?</p> <p>Çfarë parashikon ky plan?</p> <p>Kërkoj te me vihet ne dispozicion një kopje e secilit plan.</p>	24.01.2023	<p><a href="https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/2.-Strategjia-e-Ndryshimeve-Klimatike-dhe-Planet-e-Vepimit-Qershor-2019-1.pdf">https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/2.-Strategjia-e-Ndryshimeve-Klimatike-dhe-Planet-e-Vepimit-Qershor-2019-1.pdf</a></p> <p><a href="https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/profili_kombetar_per_menaxhimin_e_kimikateve_2012_AI-1.pdf">https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/profili_kombetar_per_menaxhimin_e_kimikateve_2012_AI-1.pdf</a></p> <p><a href="https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-505-2018-NOQ.pdf">https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-505-2018-NOQ.pdf</a></p> <p><a href="https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-412-2019-menaxhimi-i-ajrit.pdf">https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-412-2019-menaxhimi-i-ajrit.pdf</a></p> <p><a href="https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/Vendim-2020-05-27-418_Per-miratimin-e-Dokumentit-te-Politikave-strategjike-dhe-te-Planit-Kombetar-per-menaxhimin-e-Integruar-te-Mbetjeve-1.pdf">https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/Vendim-2020-05-27-418_Per-miratimin-e-Dokumentit-te-Politikave-strategjike-dhe-te-Planit-Kombetar-per-menaxhimin-e-Integruar-te-Mbetjeve-1.pdf</a></p> <p><a href="https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Dokumenti-i-Politikave-Strategjike_AL.pdf">https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Dokumenti-i-Politikave-Strategjike_AL.pdf</a></p> <p><a href="https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-814-2019-per-pyjet-ne-Shqiperi.pdf">https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-814-2019-per-pyjet-ne-Shqiperi.pdf</a></p> <p><a href="https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Dokumenti-i-Politikave-Strategjike-per-Mbrojtjen-e-Biodiversitetit.pdf">https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Dokumenti-i-Politikave-Strategjike-per-Mbrojtjen-e-Biodiversitetit.pdf</a></p>	Përfunduar	0

				Ndërsa planet e zbatimit për njësit e qeverisjes vendore bëhen nga bashkitë.		
6.	20.01.2023	<p>Kërkesë për informacion: Në periudhën 2017-2022, sa hotele ka klasifikuar Ministria e Turizmit me 5 yje në Republikën e Shqipërisë, në bazë të VKM Nr.730, datë 20.10.2016,dhe akteve nënligjore pasardhëse në këtë fushë.</p> <p>2. Kërkoj të më vihet në dispozicion lista e hoteleve të klasifikuara me 5 yje deri në datën 31.12.2022</p>	24.01.2023	<p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka klasifikuar si hotele me 5 yje, 7 (shtatë) struktura akomoduese.</p> <p>Listën e tyre e gjeni si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Hotel “The Plaza Tirana”</li> <li>• Hotel “Marina Bay”</li> <li>• Hotel “Mak Albania”</li> <li>• Hotel “ Lot Boutique”</li> <li>• Hotel “MK Hotels”</li> <li>• Hotel “Radisson Collection Morina Hotel Tirana”</li> <li>• Hotel “SPV Lura”</li> </ul>	Përfunduar	0
7.	23.01.2023	<p>Kërkesë për informacion : Se bashku me Fondin Shqiptar te Zhvillimit jemi duke zbatuar projektin "Zhvillimi i Data bazës së Rrjetit Rrugor Rajonal dhe Lokal, Vlerësimi</p>	24.01.2023	<p>Në vijim të kërkesës tuaj, ju bëjmë me dije se informacionin e kërkuar e keni në link-et bashkëlidhur dhe në tabelën attach.</p> <p><a href="https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Lista-e-agjencive-te-udhetimit.pdf">https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Lista-e-agjencive-te-udhetimit.pdf</a></p> <p><a href="https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/Lista-e-operatoreve-turistike.pdf">https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/Lista-e-operatoreve-turistike.pdf</a></p>	Përfunduar	0

		<p><i>dhe Prioritizimi i Investimeve", i cili synon krijimin e një inventari te plote te rrjetit rrugor rajonal dhe lokal ne te gjithë Shqipërinë.</i></p> <p>Ne kuadër te këtij projekti, na nevojiten disa te dhëna mbi sektorin e turizmit te tilla si lista e strukturave akomoduese, numri përkatës i shtretërve për strukture, rëndësia e destinacioneve turistike, numri i bizneseve turistike aktive etj.</p> <p>A ekziston një data bazë e tille te dhënash mbi sektorin e turizmit qe mund ta ndani me ne?</p>		<p><a href="https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Lista-me-subjektete-e-certifikuara-te-agroturizmit.pdf">https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Lista-me-subjektete-e-certifikuara-te-agroturizmit.pdf</a></p> <p><a href="https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Lista-e-subjektete-me-Certifikaten-Parapake-te-Agroturizmit.pdf">https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Lista-e-subjektete-me-Certifikaten-Parapake-te-Agroturizmit.pdf</a></p> <p><a href="https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/Lista-e-strukturave-akomoduese-te-kategorizuara.pdf">https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/Lista-e-strukturave-akomoduese-te-kategorizuara.pdf</a></p> <p><a href="https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/Lista-e-Operatoreve-te-Turizmit-Detar-PDF.pdf">https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/Lista-e-Operatoreve-te-Turizmit-Detar-PDF.pdf</a></p>		
8.	23.01.2023	Kërkesë për informacion: Duke qenë se ka disa vendime mbi zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar të	23.01.2023	Deleguar te Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, kthyer përgjigje nga AKZM	Përfunduar	0

		<p>Tomorit dhe shfuqizime te tyre nga Gjykata, ju lutem mund të më siguroni vendimin aktualisht ne fuqi, ku mbështetet zgjerimi i Parkut Kombëtar te Tomorit, siç parashikohet p.sh. ne vendimin nr.611, dt.11.9.2019. Me thoni është ky VKM përfundimtar, apo te tjerë dhe a është ne fuqi ai qe te jemi te sakte me kuadrin ligjor si fillim.</p> <p>2. Argumentimin mjedisor ku mbështetet vendimi për ta zgjeruar Parkun Kombëtar te Tomorit.</p> <p>3. Çfarë kufizimesh zbatohen ne një zone ZPT ku zbatohet shkalla e dyte e mbrojtjes? Çfarë ndalohet dhe çfarë lejohet ne një zone te tille, siç është zona</p>				
--	--	---	--	--	--	--

	<p>shtese e Parkut Kombëtar te Tomorit?</p> <p>4. Dokumentin e Planit Shtese te Menaxhimit te Sipërfaqes se Zgjeruar si pjese e Planit te Menaxhimit te Parkut Kombëtar te Tomorit, hartuar nga MTM ne bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore dhe vendore.</p> <p>5. Cilat janë masat e marra nga MTM për rehabilitimin e sipërfaqes se përfshirë ne Park Kombëtar ne Tomor e cila edhe aktualisht, është jashtëzakonisht e dëmtuar nga aktiviteti i guroreve?</p> <p>6. Ju lutem jepni një sqarim cili është shpjegimi qe një sipërfaqe përfshihet ne Park Kombëtar dhe</p>				
--	---	--	--	--	--

		lihet si gërmadhe, vite pas këtij vendimi?				
9.	27.01.2023	Kërkesë për informacion: Vendimet e “Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve” të mbledhjes së mbajtur me datë 11 janar 2022  2- Procesverbalin e mbledhjes Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të datës 11 janar 2022	31.01.2023	Kthyer përgjigje bashkëlidhur informacionin e kërkuar.	Përfunduar	0
<b>Nr . (1)</b>	<b>Data e regjistrimit të kërkesës (2)</b>	<b>Objekti (3)</b>	<b>Data e kthimit të përgjigjes (4)</b>	<b>Përgjigja(5)</b>	<b>Statusi i kërkesës (6)</b>	<b>Tarifa (7)</b>
10.	6.02.2023	Kërkesë për informacion: 1. Kompanitë e pajisura me licencë të tipit “III.2.B” për vitin 2017 dhe vendimin përkatës	14.02.2023	Kthyer përgjigje bashkëlidhur informacionin e kërkuar.	Përfunduar	0

	<p>nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.</p> <p>2. Kompanitë e pajisura me licencë të tipit “III.2.B” për vitin 2018 dhe vendimin përkatës nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.</p> <p>3. Kompanitë e pajisura me licencë të tipit “III.2.B” për vitin 2019 dhe vendimin përkatës nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.</p> <p>4. Kompanitë e pajisura me licencë të tipit “III.2.B” për vitin 2020 dhe vendimin përkatës nga Ministria e</p>				
--	---	--	--	--	--

		<p>Turizmit dhe Mjedisit.</p> <p>5. Kompanitë e pajisura me licencë të tipit "III.2.B" për vitin 2021 dhe vendimin përkatës nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.</p> <p>6. Kompanitë e pajisura me licencë të tipit "III.2.B" për vitin 2022 dhe vendimin përkatës nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.</p>				
11	15.02.2023	Kërkesë për informacion: Pse u ndërpre projekti i vitit 2015 ku premtohet Ri natyralizimi i Kodrës së Currilave në Durrës ku premtohet mbjellja e 50 mijë fidanëve?	27.02.2023	Ne lidhje me pyetjen e pare se: "Pse u ndërpre projekti i vitit 2015 ku premtohet Ri natyralizimi i Kodrës së Currilave në Durrës ku premtohet mbjellja e 50 mijë fidanëve? ", bëjmë me dije se ne janar te vitit 2016, fondi pyjor dhe kullësor kaloi ne administrim dhe pronësi te Njësitve te Vetëqeverisjes Vendore (NjVV), ne rastin konkret te Bashkisë Durrës. Si rrjedhoje, administrimi dhe vazhdimësia e projekteve mbi objektin Kodra e		

		- A ka një plan për ta shndërruar këtë zonë në një shëtitore të lidhur me Kodrën e Vilës, siç ka qenë planifikuar		Curilave, nga janari 2016, është e drejte dhe kompetence e Bashkisë Durrës.  Ne lidhje me pyetjen e dyte se: "A ka një plan për ta shndërruar këtë zonë në një shëtitore të lidhur me Kodrën e Vilës, siç ka qenë planifikuar?" kjo pyetje ta adresojë për Bashkisë Durrës, pasi jo vetëm zona ne fjale është ne përgjegjësi administrimi te kësaj bashkie, por edhe për faktin qe çdo NjVV, tashme ka nja projekt te Planifikimit te Territorit nen administrimin e saj.		
12	21.02.2023	1.A ka donjë projekt Ministria e Turizmit në lidhje me fshatin Lavdar të Korçës që të kthehet në fshat turistik?  2.Nëse po , çfarë vlerë do të ketë ky projekt?  3.Nëse po, në çfarë faze është projekti?  4.Nëse jo , a është planifikuar që të ketë një projekt të tillë për fshatin Lavdar?  5.A ndodhet fshati Lavdar në listën e	03.03.2023	Për fshatin Lavdar, referuar vendimit Nr. 21, datë 12.1.2018 për disa shtesa në vendimin nr. 709, datë 29.10.2014, Të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014– 2020”, ju bëjmë me dije se:  Fshati Lavdar, nuk përfshihet në listën e 100 fshatrave të programit të sipërcituar ose të ndonjë projekti aktual.	Përfunduar	0

		projektit “100 fshatrat” ?				
13	20.02.2023	<p>Kërkesë për informacion ne lidhje me relacionet e projektvendimeve si me poshtë:</p> <p>1.Për miratimin e ndryshimit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” vresht në “tokë urbane” truall të sipërfaqes 390.99 m2, pjesë e pasurisë me numër 1/394, dhe të sipërfaqes 269.13 m2, pjesë e pasurisë me numër 2/465, zona kadastrale 1476, Bashkia Dropull</p> <p>2. Për një ndryshim në vendimin nr. 298, datë 20.4.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e</p>	03.03.2023	Përfunduar dërguar informacioni kërkuar.	Përfunduar	0

		<p>Agjencisë Kombëtare të Turizmit"</p> <p>3. Për dhënien e statusit të veçantë "Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special" aplikuesit "Green Coast" sh.p.k</p>				
14	22.02.2023	<p>Kërkesë për informacion: 1. Sa është numri i “të sinjalizuarve” në organizatën tuaj, gjatë pesë viteve të fundit (2018;2019; 2020; 2021; 2022) dhe në secilin prej viteve të mësipërme?</p> <p>2. Cila është struktura e njësisë përgjegjëse (numri i anëtarëve të</p>		<p>1. Sa është numri i “të sinjalizuarve” në organizatën tuaj, gjatë pesë viteve të fundit (2018;2019; 2020; 2021; 2022) dhe në secilin prej viteve të mësipërme.</p> <p>Gjatë pesë viteve 2018 – 2022, në strukturën përgjegjëse për sinjalizimin nuk është regjistruar asnjë rast sinjalizimi për rrjedhojë nuk kemi patur të sinjalizuar.</p> <p>2. Cila është struktura e njësisë përgjegjëse (numri i anëtarëve të kësaj strukture; formimi, statusi dhe niveli përfaqësues administrativ i anëtarëve të saj) që regjistron, shqyrton dhe inspekton procedurat e hetimit administrativ të nisura për shkak të sinjalizimeve të marra nga sinjalizuesit, si dhe hetimet për mbrojtjen e</p>		

	<p>kësaj strukture; formimi, statusi dhe niveli përfaqësues administrativ i anëtarëve të saj) që regjistron, shqyrton dhe inspekton procedurat e hetimit administrativ të nisura për shkak të sinjalizimeve të marra nga sinjalizuesit, si dhe hetimet për mbrojtjen e sinjalizuesve, brenda autoritetit publik; mbi ç ‘kritere është bërë përzgjedhja dhe funksionimi i njëjësive përgjegjëse?</p> <p>3.Sa sinjalizime të brendshme janë regjistruar në organizatën tuaj, gjatë periudhës në fjalë?</p> <p>4. A ka pasur rast kur anëtarët e njëjësive përgjegjëse kanë deklaruar se kanë qënë në kushtet e konfliktit të interesit, përpara</p>		<p>sinjalizuesve, brenda autoritetit publik; mbi ç ‘kritere është bërë përzgjedhja dhe funksionimi i njëjësive përgjegjëse.</p> <p>Në zbatim të pikës 2 të VKM nr.816, datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njëjësive përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, struktura përgjegjëse për sinjalizimin në MTM është Drejtoria e Auditimit të Brendshëm dhe përbëhet nga Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe një specialist i saj.</p> <p>3.Sa sinjalizime të brendshme janë regjistruar në organizatën tuaj, gjatë periudhës në fjalë.</p> <p>Për periudhën 2018 – 2022 nuk kemi patur raste sinjalizimi të brendshëm.</p> <p>4. A ka pasur rast kur anëtarët e njëjësive përgjegjëse kanë deklaruar se kanë qënë në kushtet e konfliktit të interesit, përpara fillimit të hetimit administrativ për shkak të një sinjalizimi? Nëse po, në ç ‘rrethana ka ndodhur; si është proceduar më tej, pas deklarimit.</p> <p>Nuk kemi patur raste sinjalizimi për rrjedhojë nuk kemi qënë në kushtet e konfliktit të interesit.</p> <p>5. Kopje e plotë e rregullores lidhur me zhvillimin e procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit.</p>		
--	---	--	---	--	--

		<p>fillimit të hetimit administrativ për shkak të një sinjalizimi? Nëse po, në ç ‘rrethana ka ndodhur; si është proceduar më tej, pas deklarimit?</p> <p>5. Kopje e plotë e rregullores lidhur me zhvillimin e procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit.</p> <p>6. Sa është numri i hetimeve administrative të kryera pas marrjes së sinjalizimeve; numri inspektimeve të kryera nga njësia përgjegjëse në kuadrin e hetimeve administrative të filluara?</p> <p>7. Sa prej hetimeve administrative të kryera në kuadrin e një sinjalizimeve kanë</p>		<p>Bashkëlidhur Rregulloren e Brendshme “Për procedurën e shqyrtimit të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja”, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.</p> <p>6.Sa është numri i hetimeve administrative të kryera pas marrjes së sinjalizimeve; numri inspektimeve të kryera nga njësia përgjegjëse në kuadrin e hetimeve administrative të filluara.</p> <p>Nuk kemi patur sinjalizimi për rrjedhojë nuk kemi patur raste të hetimit administrative.</p> <p>7. Sa prej hetimeve administrative të kryera në kuadrin e një sinjalizimeve kanë rezultuar në shkelje administrative.</p> <p>Nuk kemi patur sinjalizimi për rrjedhojë nuk kemi patur raste të hetimit me shkelje administrative.</p> <p>8. Sa është numri i sinjalizimeve të cilat nuk janë depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga legjislacioni (60/2016); ose nuk kanë pasur elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.</p> <p>Nuk kemi patur raste sinjalizimi që nuk janë depozituar sipas formës dhe përmbajtjes ose që nuk kanë pasur elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.</p> <p>9. Sa është numri i sinjalizimeve të bazuara, të cilat i keni referuar në prokurori apo në Policinë e Shtetit</p>		
--	--	--	--	---	--	--

		<p>rezultuar në shkelje administrative?</p> <p>8. Sa është numri i sinjalizimeve të cilat nuk janë depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga legjislacioni (60/2016); ose nuk kanë pasur elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale?</p> <p>9. Sa është numri i sinjalizimeve të bazuara, të cilat i keni referuar në prokurori apo në Policinë e Shtetit?</p> <p>10. Sa është numri i kërkesave për mbrojtje nga ana e sinjalizuesve, të cilët pretendojnë se janë, apo kanë qënë, subjekt i një akti hakmarrjeje? A janë kryer hetime administrative ndaj këtyre pretendimeve?.</p>		<p>Nuk kemi patur raste sinjalizimi të cilët I kemi referuar në prokurori apo në Policinë e Shtetit</p> <p>10. Sa është numri i kërkesave për mbrojtje nga ana e sinjalizuesve, të cilët pretendojnë se janë, apo kanë qënë, subjekt i një akti hakmarrjeje? A janë kryer hetime administrative ndaj këtyre pretendimeve.</p> <p>Nuk kemi patur raste kërkesash për mbrojtje nga ana e sinjalizuesve, të cilët pretendojnë se janë, apo kanë qënë, subjekt i një akti hakmarrjeje.</p> <p>11. Kopje të raporteve vjetore të njësive përgjegjëse mbi zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.</p> <p>Raportet vjetore të veprimtarisë së Njesisë Përgjegjëse të Sinjalizimit të dërguara pranë ILDKPKI janë pa raste sinjalizimi.</p>		
--	--	---	--	---	--	--

		11. Kopje të raporteve vjetore të njësive përgjegjëse mbi zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.				
15	22.02.2023	<p>Kërkesë për informacion: 1. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit B për vitin 2017.</p> <p>2. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit B për vitin 2018.</p> <p>3. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit B për vitin 2019.</p> <p>4. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit B për vitin 2020.</p> <p>5. Subjektet që kanë marrë licencën e</p>	7.03.2023	Përfunduar dërguar informacioni i kërkuar.	Përfunduar	0

	<p>mjedisit të tipit B për vitin 2021.</p> <p>6. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit B për vitin 2022.</p> <p>7. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit B për vitin 2023.</p> <p>8. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit A për vitin 2017.</p> <p>9. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit A për vitin 2018.</p> <p>10. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit A për vitin 2019.</p> <p>11. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit A për vitin 2020.</p>				
--	--	--	--	--	--

		<p>12. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit A për vitin 2021.</p> <p>13. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit A për vitin 2022.</p> <p>14. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit A për vitin 2023.</p>				
16	24.02.2023	<p>Kërkese për informacion: Sa gjoba janë vendosur ndaj bizneseve që nuk kanë zbatuar ligjin për zëvendësimin e qeseve plastike? Sa gjoba janë vendosur në Tiranë dhe sa në rrethe?</p> <p>2. Sa janë vlerat minimale dhe</p>	03.03.2023	<p>1. Sa gjoba janë vendosur ndaj bizneseve që nuk kanë zbatuar ligjin për zëvendësimin e qeseve plastike? Sa gjoba janë vendosur në Tiranë dhe sa në rrethe?</p> <p>Përsa i përket pyetjes së parë Ju bëjmë me dije se Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Elbasan, Korçë ka kryer inspektime në subjektet që kanë si aktivitet kryesor prodhimin e qeseve plastike mbajtëse me ose pa veshë sipas standardeve të përcaktuara në VKM-në Nr. 367, datë 30.5.2022“Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme” i ndryshuar, nga ku ka vendosur 3 masa administrative me gjobë me vlerë me nga 500.000 lekë.</p>	Përfunduar	0

		<p>maksimale që janë vendosur për këto subjekte?</p> <p>3. Sa është shuma e mbledhur nga këto masa administrative?</p> <p>4. Çfarë lloje biznesesh janë gjobitur kryesisht?</p>		<p>Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër ka kryer inspektime në subjektet që kanë si aktivitet kryesor prodhimin e qeseve plastike mbajtëse me ose pa veshë sipas standardeve të përcaktuara në VKM-në Nr. 367, datë 30.5.2022“Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme” i ndryshuar, nga ku është konstatuar se subjektet prodhojnë qese plastike sipas kërkesave ligjore.</p> <p>Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë ka kryer inspektime në subjektet që kanë si aktivitet kryesor prodhimin e qeseve plastike mbajtëse me ose pa veshë sipas standardeve të përcaktuara në VKM-në Nr. 367, datë 30.5.2022“Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme” i ndryshuar, nga ku është konstatuar se subjektet prodhojnë qese plastike sipas kërkesave ligjore.</p> <p>2. Sa janë vlerat minimale dhe maksimale që janë vendosur për këto subjekte?</p> <p>Masat administrative me gjobë janë vendosur me vlerën 500.000 lekë.</p> <p>3. Sa është shuma e mbledhur nga këto masa administrative?</p>		
--	--	---	--	---	--	--

				<p>Aktualisht nuk janë depozituar të ardhura nga masat administrative për mos zbatim të ligjit për zëvendësimin e qeseve plastike sepse janë në proces ekzekutimi.</p> <p>4.Cfarë llojë biznesesh janë gjobitur kryesisht?</p> <p>Në zbatim të Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, VKM-së, nr. 568, datë 17.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”si dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatueshmëria e VKM-së Nr. 367, datë 30.5.2022 “Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme” i ndryshuar, Ju bëjmë me dije se, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit kanë detyrim të ushtrojnë kontrolle vetëm në subjektet që kanë si aktivitet kryesor prodhimin e qeseve plastike mbajtëse me ose pa veshë. Qëllimi i këtyre kontrolleve konsiston në respektimin e kërkesave ligjore për prodhimin e qeseve plastike mbajtëse sipas standardeve të përcaktuara në VKM-në Nr. 367, datë 30.5.2022.</p>	
--	--	--	--	--	--

17	28.02.2023	<p>Në bazë të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar në 17 Mars 2022, në</p> <p>Shqipëri ndalohej importi dhe përdorimi i qeseve plastike. Lidhur me këtë kërkohet informacion për</p> <p>çështjet e mëposhtme;</p> <p>A respektohet në masën e duhur ligji për ndalimin e përdorimit të qeseve plastike, a shihet një</p> <p>ndërgjegjësim nga ana e bizneseve dhe qytetarëve?</p> <p>A ka nisma të tjera Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për të</p>	03.03.2023	<p><b><u>Pyetje:</u></b></p> <p>1. <i>Në bazë të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar në 17 Mars 2022, në Shqipëri ndalohej importi dhe përdorimi i qeseve plastike. Lidhur me këtë kërkohet informacion për çështjet e mëposhtme;</i></p> <p><i>A respektohet në masën e duhur ligji për ndalimin e përdorimit të qeseve plastike, a shihet një ndërgjegjësim nga ana e bizneseve dhe qytetarëve?</i></p> <p><b><u>Përgjigje:</u></b></p> <p>Në kuadër të zbatimit të ligjit Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka miratuar Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 367, datë 30.5.2022 “Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme” i ndryshuar, e cila përcakton parametrat teknike të trashësisë së mureve të qeses plastike gjatësinë e gjerësinë e qeses plastike, si dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij akti.</p> <p>Në këtë kuadër dhe ndjekjen e këtij akti është ngritur me Urdhër të Kryeministrit Nr. 190, datë 15.11.2022 “Për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe funksionimin të Task – Forcës për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve</p>		
----	------------	---	------------	--	--	--

		<p>ndaluar plastikën dhe në produkte të tjera si</p> <p>shishet e ujit, qumështit etj. apo edhe ambalazhimin e produkteve ushqimore dhe ushqimore?</p>		<p>plastike mbajtëse të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme”.</p> <p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit përpara hyrjes në fuqi të akteve të sipërcituar, ka ndërmar një sërë aktivitete ndërgjegjësimi nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Subjektet e prodhimit, riciklimit dhe importimit;</li> <li>2. Në shkolla 9 vjeçare, të mesme dhe në Universitete Publik/Privat;</li> <li>3. Në Biznese dhe pika Tregtare;</li> <li>4. Në bashkëpunim me projektin GIZ të Qeverisë Gjermane dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka zhvilluar takime në 61 Bashki etj..</li> </ol> <p>Aktualisht po vijon inspektimi nga Task - Forca në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë nga institucionet e përcaktuar në Urdhër, deri më datë 1 Tetor 2023 në të cilën do të hartohet raporti mbi problematikat dhe progresin e zbatimit të legjislacionit në fuqi.</p> <p><b><u>Pyetje:</u></b></p> <p><i>2. A ka nisma të tjera Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për të ndaluar plastikën dhe në produkte të tjera si shishet e ujit, qumështit etj. apo edhe ambalazhimin e produkteve ushqimore dhe ushqimore?</i></p> <p><b><u>Përgjigje:</u></b></p>		
--	--	--	--	--	--	--

Nr . (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja(5)	Statusi i kërkesës (6)	Tarifa (7)
18.	08.03.2023	<p>Kërkesë për informacion: A parashikon Kodi i Punës ndërprerje të marrëdhënieve të punës për shkak të shkeljes te rregullores së brendshme për dhënien e intervistës pa miratimin e eprorit dhe a ka Ministria e Turizmit dhe Mjedisit një prononcim për këtë rast ?</p>	24.03.2023	<p>Për sa i takon pyetjes së 2, të sipërcituar, ju sqarojmë që për produktet si shishet e ujit, qumështit etj. apo edhe ambalazhimin e produkteve ushqimore dhe ushqimore, nuk ka nisëm për ndalimin në vendin tonë.</p> <p>Në vijim të emali-t Tuaj, përmes së cilit kërkohet informacion dhe prononcim nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të z. *** ***, me detyrë Drejtor i Administratë së Zonave të Mbrojtura Fier, për shkak të shkeljes së Rregullores së Brendshme për dhënien e intervistës pa miratimin e eprorit, ju bëjmë me dije si vijon:</p> <p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me marrjen dijani mbi rastin nga institucioni i saj i varësisë, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, ka shqyrtuar procedurën e ndjekur për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të z*** dhe ka vlerësuar se është e nevojshme të rishikohet edhe njëherë vendimmarrja e punëdhënësit, pasi ka nevojë për argumente dhe informacion më konkret, nëse ka patur raste të përsëritura të këtyre shkeljeve nga ana e punëdhënësit apo të vërtetohet nëse shkelja ka sjellë pasoja shumë të rënda në mbarëvajtjen e punës për marrjen e masës ekstreme “Lirim nga detyra”.</p> <p>Në këtë kuadër, pas shqyrtimit edhe një herë të procedurës së ndjekur, fakteve dhe provave të ndjekura nga AKZM,</p>	Përfunduar	0

				ky institucion, në cilësinë e punëdhënësit, ka anuluar urdhrin për Lirim nga detyra të z. **** *****.		
29.	13.03.2023	Kërkesë për informacion: Vini në dispozicion: Listën e targave të automjeteve ekzistuese në pronësi të institucionit tuaj.	24.03.2023	Kthyer përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.	Përfunduar	0
20	20.03.2023	Kërkesë për informacion ne lidhje me relacionet e projektvendimeve te miratuara: 1-Për përjashtimin nga ndalimi i gjuetisë, për qëllime shkencore pasvaksinale, të kafshëve të vaksinuara, në kuadër të projektit IPA 2020, “Kontrolli dhe çrënjosja e sëmundjes së tërbimit-faza IV”  2-Për një ndryshim në vendimin nr. 325, datë 31.5.2018, të Këshillit	31.03.2023	Përfunduar kthyer përgjigje me e-mail informacioni i kërkuar.	Përfunduar	0

		<p>të Ministrave, “Për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të përzgjedhjes së projekteve në turizëm”</p> <p>3-Për shpalljen e habitatit të tulipanit shqiptar “Monument natyror”</p> <p>4-Për shpalljen e ekosistemit natyror të lumit Vjosa “Park Kombëtar”, kategoria II</p> <p>5-Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 569, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit", të ndryshuar</p>				
22	27.03.2023	Kërkesë për informacion në lidhje me: 1.Informacion	3.04.2023	Në vijim të kërkesë ju bëjmë me dije se në linket bashkëlidhur janë dy VKM-të e kërkuara, vkm ka bashkëlidhur dhe listën e inventarit si është dhe në	Përfunduar	0

	<p>mbi hartat e Bashkive Korçë, Kolonjë, Maliq, Devoll dhe Pogradec të miratuara me VKM-në nr.433, datë 08.06.2016 "Për Transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive".</p> <p>2. Informacion mbi hartat e Bashkive Korçë, Kolonjë, Maliq, Devoll dhe Pogradec të miratuara me VKM-në nr.398, datë13.05.2020, Për disa ndryshime ne vendimin Nr.433, datë 8.06.2016, të Këshillit të Ministrave, Për Transferimin në</p>		<p>titullin, për hartat ju duhet ti drejtoheni Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.</p> <p><a href="https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/05/13/398/9b7b8688-7e7f-4386-b1de-9828da6a2df7">https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/05/13/398/9b7b8688-7e7f-4386-b1de-9828da6a2df7</a></p> <p><a href="https://qbz.gov.al/eli/vendim/2016/06/08/433/b9698007-699c-4810-9d3e-ffec67509c2b">https://qbz.gov.al/eli/vendim/2016/06/08/433/b9698007-699c-4810-9d3e-ffec67509c2b</a></p>		
--	---	--	---	--	--

		pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive.				

Nr (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja(5)	Statusi i kërkesës (6)	Tarifa (7)
23	4.04.2023	<p>Kërkesë për informacion: konkretisht hartat e Ekonomive Pyjore për VKM nr.433 dhe VKM nr.398.</p> <p>Bazuar ne Udhëzimin nr.1, date 26.01.2016 "PER MBAJTJEN E KADASTRES SE FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR KOMBETAR", ju jeni Autoriteti qe mban dhe përditëson hartat dhe fondin pyjor/kullor. Për me tepër ju jeni edhe institucioni qe ka çuar ne Këshillin e Ministrave këto dy VKM, që pa harta janë te paplota.</p>	07.04.2023	<p>Lidhur me kërkesën për hartat e ekonomive pyjore për VKM nr. 433/2016 dhe 398/2020 ju sqaroj sa me poshtë:</p> <p>Në radhe të parë që nga titulli i VKM-ve përcaktohet se transferimi i fondit pyjor dhe kullor publik në pronësi të bashkive është bere me liste inventari dhe jo me harta.</p> <p>Së dyti, bazuar ne këto akte ligjore është kryer regjistrimi i fondit pyjor dhe kullor publik ne pronësi te bashkive dhe informacioni për statusin juridik të një prone brenda këtij fondi, përfshirë edhe kartelën e pasurisë apo fragmentin e hartës , ndodhet ne ASHK Vendore përkatëse. Behet aplikim dhe kërkohet informacion për një pronë të caktuar.</p> <p>Se treti, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është institucion politikebërës dhe bazuar në Ligjin e Pyjeve 57/2020, janë strukturat e menaxhimit te pyjeve te bashkive ato qe bëjnë azhornimet kadastrale ( si pronare te fondit pyjor dhe kullor publik) dhe procesi i azhornimit përfundon ne Agjencinë Kombëtare te Pyjeve.</p>	Përfunduar	0

24	5.04.2023	<p>Kërkesë për informacion: Kërkojmë nga ju të na jepet informacioni i kërkuar:</p> <p>1. Sa investime strategjike ka në ministrinë tuaj?</p> <p>2. Specifikoni tipologjinë e investimeve strategjike (në turizëm, mjedis)?</p> <p>3. Kush janë investitorët strategjikë(emrat e kompanive, personit fizik)?</p> <p>4. Në çfarë zonash janë këto investime strategjike?</p> <p>5. Në çfarë viti e kanë marrë statusin</p>		Në proces		
----	-----------	---	--	-----------	--	--

		e investitorit strategjikë?				

**Shënim:**

Regjistri përditësohet çdo tre muaj.

- (1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.
- (2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.
- (3) Identifikohet lloji i kërkesës.
- (4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.

*(Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”)*

- (5) Ndihej kërkuar për të njohur ecurinë e procesit.
- (6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.